

**Fatos Tarifa**

**Kërkimi i  
legjitimitetit  
dhe venitja e utopisë**



Globus R.

**Pasthënie**

Me rënien e Murit të Berlinit shume njerëz menduan se transformimet e mëdha politike dhe ekonomike që filluan të kryhen ne Europën Qendrore dhe Lindore do të sillnin një epokë të re paqeje dhe bashkëpunimi në mbarë botën. Megjithë problemet e vazhdueshme me të cilat përballen vendet e Botës së Tretë, shembja e komunizmit ngjalli shpresën për një rend të ri botëror. Fatkeqësisht, periudha pas Luftës së Ftohtë është karakterizuar nga më pak harmoni dhe paqe nga sa ishte parashikuar dhe shpresuar.

Në shumë drejtues shtetesh ka munguar vullneti që qeveritë e tyre të respektojnë dhe mbrojnë liritë dhe të drejtat e individit. Në ish Jugosllavinë e viteve 1990-të, emrat Sarajevo, Mostar, Srebrenica, Vukovar, Prishtina dhe Mitrovica nuk do të harrohen lehtë. Madje edhe sot, nje varg ngjarjesh na kujtojnë mungesën e stabilitetit dhe mosmarëveshjet që ekzistojnë për shkak të konflikteve në Ballkan. Prania e një force të NATO-s në Bosnje dhe në Kosovë dëshmon për një tendencë të re në politikën ndërkombëtare, atë të ndërhyrjes së një pjese të komunitetit ndërkombëtar në vende apo rajone të caktuara. Kuvajti, Bosnja, Kosova, Sudani dhe, së fundi, Afganistani, janë shembuj të kësaj politike të re intervencioniste. Sidoqoftë, intervencionizmi duhet të shoqërohet me respektimin e legjitimitetit politik. Nëse mund të flitet për një kohë më të përshtatshme për ta vlerë-

suar me interes conceptin e legjitimitetit politik, kjo kohë është pikërisht sot, në fillim të shekullit të 21-të.

Është për këtë arsye që, në një kontekst të gjerë, libri i Fatos Tarifës *Kërkimi i legjitimitetit dhe venitja e utopisë* merr rëndësinë e një vepre krejt të veçantë në literaturën e sotme politike e sociologjike, së cilës i duhet referuar kushdo që merr përsipër të shqyrtojë problemin e legjitimitetit.

Duke shfrytëzuar si pikënisje një literaturë të gjerë mbi legjitimitetin politik si edhe një material të pasur historik e faktik mbi kushtet politike dhe ato social ekonomike në Europën Lindore në periudhën para dhe pas Luftës së Dytë Botërore, Tarifa bën një analizë të thellë sociologjike, historiko-krahasuese, e cila synon të argumentojë praninë në shkallë të caktuara të autoritetit legjitim në ato vende të Europës, të cilët u sunduan për afro gjysëm shekulli nga regjime komunist.

Rëndësia e legjitimitetit politik, sipas Tarifës, nuk mund të nënvlerësohet, pasi "legjitimiteti është një parakusht i domosdoshëm për ushtrimin efektiv të autoritetit". Ajo çka e bën tepër interesant, original, dhe veçanërisht të dobishëm diskutimin e tij mbi legjitimitetin është se ky autor sfidon me argumente bindës, (të cilët mbështeten mbi një njohje të thellë dhe të drejtpërdrejtë të të realiteteve historikë e politiko-socialë që analizon), pikëpamjen ortodokse, të mbrojtur nga shumë akademikë dhe politikanë në Perëndim, se vendet komuniste të Europës Qendrore dhe Lindore përbënin një rajon homogjen dhe se drejtimi i tyre prej partive komuniste dhe elitave të tyre ishte qysh nga fillimi krejtësisht ilegjitim. Argumenti më i përgjithshëm ka qenë ky: rendi komunist, në të gjithë këta vende ka qenë ilegjitim qysh në fillim, pasi komunizmi, si ideologji dhe praktikë, ishte dhe mbeti deri në fund "i huaj" për shoqëritë e tyre, i imponuar thjesht nga prania e Ushtrisë së Kuqe në territoret e pushtuara prej saj. Me fjalë të tjera, komu-

nizmi ishte thjesht terror i maskuar si bindje e imponuar.

Një pikëpamje e tillë mbi Europën komuniste ka qenë mjaft e përhapur, madje mbizotëruese, gjatë gjithë periudhës së Luftës së Ftohtë. *Kërkimi i legjitimitetit dhe venitja e utopisë* bën shumë për ta zhvlerësuar atë. Duke e çmitizuar çështjen e "ilegjitimitetit" të rendit komunist ne vendet e Europës Lindore, Tarifa në fakt jep një kontribut shumë të rëndësishëm në ndryshimin e të perceptuarit tonë mbi ngjarje epokale të gjysmës së dytë të shekullit të 20-të.

Ajo çka i jep kësaj vepre një vlerë akoma më të spikatur është fakti se ajo vazhdon të ketë rëndësi për ne edhe pasi kemi hyrë në shekullin e 21-të. Edhe pse vendet e Europës Qendrore dhe Lindore kanë kryer një transformim rrënjësor të shoqërive të tyre, duke adoptuar parimet dhe praktikën e demokracisë, ka akoma vende në rajone të ndryshme të botës, të cilat drejtohen nga regjime autoritariste, përfshirë këtu edhe regjime komuniste. *Kërkimi i legjitimitetit* u vjen në ndihmë studjuesve të sistemeve politikë dhe sociologëve krahasues të kuptojnë problemet e ndërlikuara të shoqërisë së sotme në ato vende në të cilat legjitimiteti i autoritetit politik është i diskutueshëm.

Gjatë shtjellimit të lëndës, autori e orienton lexuesin në atë çka përbën në të vërtetë "kërkimin" e natyrës së autoritetit legjitim. Nga shfaqja e saj më e hershme në formën e teorisë së të drejtës hyjnore në formën e saj të sekularizuar, të një konceptimi humanist, siç e ndeshim në ditët tona, sipas të cilit legjitimiteti është atribut i asaj qeverie e cila *besohet* nga qytetarët se meriton respekt dhe bindje dhe për këtë arsye i japin asaj dhe vendimeve të saj "aprovim moral", legjitimiteti politik ka pasur një rëndësi jetike në peisazhin politik të çdo shoqërie.

Literatura e shkruar mbi këtë subjekt është mjaft e

gjerë dhe e larmishme. Duke gjykuar nga eksplorimi pothuajse ezaures që i bën Tarifa kësaj literature, veçanërisht nga shtjellimi i tij mbi konotacionin *objektiv* të konceptit "legjitimitet" (e drejta për të sunduar përmes proceseve dhe procedurave politike) dhe atij *subjektiv* (pranimi ose njohja në përgjithësi e këtij sundimi nga qytetarët), duket qartë se autori i jep një vlerë të veçantë këtij të fundit. Ndoshta është legjitimiteti i kuptuar në formën e besimit të qytetarëve në autoritetin legjitim të shtetit, besim ky i krijuar nga një sërë kushtesh të veçantë sociale dhe ekonomike dhe nga një klimë e veçantë politike dhe ideologjike ai që, në një mënyrë a në një tjetër, ka ushqyer dhe mbajtur gjallë pikëpamjen ortodokse mbi karakterin ilegjitim të shteteve komuniste të Europës Qendrore dhe Lindore. Këtë ka parasysh Tarifa kur analizon shkallën e legjitimitetit dhe natyrën e tij, si edhe fazat e ndryshme në të cilat legjitimiteti i rendit komunist në këto vende u venit dhe u shua.

Tarifa merr atë çka është një *causal nexus* shumë i komplikuar dhe e redukton atë në diçka lehtësisht të menaxhueshme. Autori është në gjendje ta bëjë këtë për shkak se ai e kupton legjitimitetin si produkt të një procesi shumëvariabëlsh, i cili përfshin si faktorë ekzogjenë ashtu edhe ata endogjenë.

Që partitë komuniste të Europës Qendrore dhe Lindore, të cilat morën në dorë pushtetin pas Luftës së Dytë Botërore, të mund të drejtonin me sukses, ato e kishin të domosdoshme të legjitimonin të drejtën e tyre për të ushtruar autoritet. Por ç'faktorë ndikuan që qytetarët e këtyre vendeve të besonin në karakterit legjitim të qeverive të tyre?

Tarifa shtjellon në një mënyrë shumë interesante dhe sistematike një varg faktorësh të rëndësishëm, të cilët shpesh kanë qenë harruar apo nënvleftësuar, si roli udhëheqës i partive komuniste në luftën kundër fuqive të Aksit, të gjendurit e komunistëve në vendin e duhur

dhe në kohën e duhur për të mbushur vakumin politik të krijuar pas Luftës pothuaj në të gjithë vendet e këtij rajoni, si edhe për të ndryshuar kursin e zhvillimit shoqëror dhe mungesën e kohezionit social në këta vende, karakterin rural të shoqërive në fjalë dhe varfërinë ekonomike të tyre, mungesën e lidërshpit të aftë e të besueshëm në këto vende për të marrë në dorë drejtimin politik të shtetit dhe të shoqërive të tyre pas Luftës, përvojën tragjike të fashizmit dhe kushtet e ardhjes së tij në pushtet në Europën perëndimore, etj.

Pavarësisht faktorëve të mësipërm, Tarifa argumenton se për të legjitimuar pushtetin e tyre, partitë komuniste në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore përdorën gjerësisht e sistematikisht të gjitha mjetet që ofrojnë indoktrinimi ideologjik, imponimi me dhunë dhe terrori. Siqodoftë, ai beson se këta të fundit, sado të rëndësishëm të kenë qenë, nuk kanë qenë faktorë të mjaftueshëm e aq më pak vendimtarë, për të ruajtur besimin e qytetarëve në karakterin legjitim të shtetit të tyre dhe për të mbajtur të pasfiduar pushtetin komunist. Ajo që e ruajti në sytë e qytetarëve natyrën legjitime të pushtetit dhe i mbajti në këmbë për një kohë të gjatë qeveritë komuniste në këto vende ishte një *autoritet konsensual*, i cili, në një masë të madhe, pranohej në mënyrë të vullnetshme nga qytetarët, duke e shndërruar kështu bindjen e tyre në një farë rutine që zgjati për shumë kohë. Siç ve në dukje Tarifa, mbajtja në këmbë e socializmit shtetror dhe besimi në legjitimitetin e tij kërkonin, veç të tjerash, një "besim utopik", besimin në idenë e një shoqërie "të barabartë për të gjithë, të drejtë, të zhvilluar, të organizuar e të drejtuar më mirë".

Tarifa, në fakt, zhvlerëson pikëpamjen tradicionale ortodokse mbi dhunën si mjeti kryesor me anë të të cilit shteti komunist ishte në gjendje të ruante legjitimitetin e tij. Sidoqoftë, në periudha të caktuara, por jo kudo në të njëjtën kohë, qeverisja komuniste njohu kriza të legji-

timitetit të saj dhe me këtë, përsëri jo kudo njëlloj, autoriteti legjitim i shteteve komunistë filloi të bjerë.

Pikëpamja konvencionale dhe ajo që shtjellon dhe argumenton Fatos Tarifa në këtë libër ofrojnë shpjegime të ndryshme shkaksore mbi këtë çështje. Ndërsa shkolla tradicionale e shikon rënien e socializmit shtetror kryesisht si pasojë e karakterit ineffiçent të sistemit ekonomik të tipit sovjetik dhe e paaftësisë së tij për të plotësuar nevojat në rritje të qytetarëve, Tarifa i shton këtij interpretimi një faktor ideologjik si një aspekt shumë të rëndësishëm. Për rrjedhojë, ai ofron një shpjegim, i cili merr parasysh si aspektin ekonomik ashtu edhe komponentin ideologjik, për të kuptuar më realisht ato procese që çuan në erozionin e legjitimitetit të socializmit shtetror dhe në rënien e këtij sistemi. Për më tepër, Tarifa e eviton të sugjeruarit e konkluzioneve të tij si përfundimtarë, duke pohuar se koha dhe kërkime të mëtejshme në këtë fushë do të provojnë vërtetësinë apo falsitetin e pikëpamjeve të tij.

Ky libër i ofron lexuesit një ndryshim perspektive. Në fakt, unë nuk mund të mendoj ndonjë introduksion më të mirë se *Kërkimi i legjitimitetit*, shkruar nga Fatos Tarifa, i cili të sfidojë dijen konvencionale në mënyrë kaq konçize, të informuar dhe të argumentuar. Për më tepër, ky libër i ofron lexuesit mundësinë për ta konsideruar mesazhin e tij si një stimul për një sfidë më të gjerë që është e një rëndësie të veçantë për ne sot. Tarifa dhe botuesit e tij kanë dhënë një kontribut me shumë vlerë në fushën e studimeve postkomuniste duke u dhënë lexuesve këtë libër në anglisht dhe në shqip. Personalisht i jam mirënjohës mikut tim, Fatos Tarifa, një sociolog i shkëlqyer dhe një diplomat i dedikuar, që më dha mundësinë të njihem me këtë vepër të tij.

**Rory J. Conces Ph.D.**

University of Nebraska at Omaha

*Gruas sime të dashur, Arta,  
dhe djemve tanë të mrekullueshëm,  
Sidrit e Jon*

Përkthyer nga origjinali anglisht:  
*The Quest for Legitimacy and the Withering Away of Utopia.*  
The Hague: Smiet, 2001.

© 2002, Fatos Tarifa

1. Legjitimiteti politik. 2. Autoriteti. 3. Socializmi shtetror.
4. Kriza e legjitimitetit të socializmit shtetror.
5. Europa Qendrore dhe Lindore. 6. Europa Juglindore.
7. Shqipëria. 8. Jugosllavia. 9. Teori politike.
10. Sociologji historike krahasuese.

Kopertina nga Sidrit Tarifa